

PROCESVERBAL
nga seanca 24. e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 8.7.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: mr. Zirjeta Jajaga (pushim vjetor).

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, dr. Ivana Stojanovska, mr. Emilija Janevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunović, Maja Damevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 24. të Këshillit. Seanca filloi në orën 13:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim- procesverbalit nga seanca 24. e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 8.7.2025 .
2. Propozim-vendim për uljen e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.
3. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj ShTR Televizioni Makpetrol ShPKNJ P Shkup për shkelje të nenit 98 paragrafi, (2) të LShMAAV dhe nenit 14, paragrafi (4) të Rregullores për teknikat e reja të reklamimit.
4. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj ShTR Alsat-M ShPK Shkup, për shkelje të nenit 54, paragrafi (1) të LShMAAV-së.
5. Propozim-vendim për donacion të mjeteve për trajtimin e të punësuarit në Agjenci.
6. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e seancës së 23-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 19.6.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi Propozim-vendimin për ndryshim të Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026. Ai shpjegoi se, duke marrë parasysh gjendjen aktuale në procedurën për ndryshim të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, veçanërisht në pjesën e financimit të Agjencisë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe mundësinë reale që ndryshimet ligjore të miratohen, propozohet të mos realizohen disa furnizime publike të parashikuara për vitin 2026. Ai theksoi se vlera totale e furnizimeve publike që propozohet të mos realizohet arrin shumën 6.089.000 denarë. Njëkohësisht, për shkak të problemeve serioze me sistemin për ftohje në Agjencion, propozohet që një pjesë e këtyre mjeteve, në shumën prej 2.754.000 denarë, të ripërdoren për blerjen e një sistemi të ri për ftohje, ngrohje dhe ventilim, si dhe të sigurohen mjete shtesë për mirëmbajtjen e sistemit të ftohjes, ngrohjes dhe ventilimit dhe për angazhimin e një firme për shërbime elektrike dhe hidraulike. Në pajtim me ndryshimet e propozuara, Planin Financiar i Agjencisë për vitin 2026 do të zvogëlohet për 3.335.000 denarë, me të ardhurat dhe shpenzimet totale që do të ulen nga 227.060.345 denarë në 223.725.345 denarë. Njëkohësisht, shuma e mjeteve të bartura nga vitet e mëparshme do të zvogëlohet nga 72.880.345 denarë në 69.545.345 denarë. Drejtori theksoi se me miratimin e ndryshimeve në Planin Financiar, do të jetë e nevojshme të bëhen ndryshimet përkatëse në Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2026, me ç'rast disa furnizime publike do të fshihen dhe do të përfshihen furnizime të reja lidhur me sistemin për ftohje, ngrohje dhe ventilim. Ai theksoi se këto ndryshime do të jenë lëndë për shqyrtim dhe miratim në njërën nga seancat e ardhshme të Këshillit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për uljen e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026, nr.05-2209/1 i datës 20.5.2026.

Të ardhurat dhe shpenzimet në total të planifikuara sipas Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026, janë zvogëluar në shumë totale prej 6.089.000,00 denarë, për shkak se nuk do të realizohen furnizimet publike si më poshtë:

- Organizimi i Ditëve të Arsimit Mediatik në shumë prej 1.770.000,00 denarë;
- Tim building(përmbledhja e aktiviteteve) për të punësuarit në shumë totale prej 1.500.000 denarë;
- Sigurim i aksesit në platformën për monitorim dhe përgatitjen e raporteve për mediat online - internet portalet dhe rrjetet sociale me fokus tek influenserët/vlogerët/kreatorët e përmbajtjes dhe për publikime lidhur me AShMA-në në shumë prej 600,000.00 denarë;
- Furnizim me pajisje audio dhe video në shumë prej 590.000,00 denarë dhe
- Çertifikimi i standardit ISO (27001:2022) - sistemi për menaxhimin e sigurisë së informacionit në shumë prej 354.000,00 denarë.

Furnizimi i pajisjeve TIK do të kryhet për 1.275.000,00 denarë më pak, përkatësisht mjetet e planifikuara deri më tani në shumë prej 3.675.000,00 denarë do të arrijnë në 2.400.000,00 denarë.

Një pjesë e mjeteve që më parë ishin të destinuara për furnizime që nuk do të realizohen, konkretisht në shumë prej 2.754.000,00 denarë, do ripërdoren për furnizime që janë të nevojshme për Agjencinë, përkatësisht:

- Furnizim me sistem të ri për ftohje, ngrohje dhe ventilim i cili do të instalohet në ndërtesën ku ndodhet selia e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Ministrisë së Sportit, në shumë prej 2.000.000,00 denarë;
- Mirëmbajtja e sistemit për ftohje, ngrohje dhe ventilim, ku mjetet e planifikuara paraprakisht në shumë prej 900.000,00 denarë për vitin 2026 do të rriten për 400.000,00 denarë, përkatësisht do të arrijnë në shumë prej 1.300.000 denarë dhe
- Angazhim i një kompanie për shërbime elektrike dhe hidraulike, ku mjetet e planifikuara deri më tani në shumë prej 300.000,00 denarë do të rriten për 354.000,00 denarë, përkatësisht do të arrijnë shumën prej 654.000,00 denarë, për shkak të nevojës për shpalljen e furnizimi të ri, pasi që mjetet nga Kontrata aktuale do të shfrytëzohen plotësisht.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, të publikojë Vendimin për miratimin e zvogëlimit të Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026, nr.05-2209/1 i datës 20.05.2026 në faqen e internetit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Pikat 3 dhe 4

Drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, dr. Zoran Trajčevski, propozoi që Udhëheqësja e Spektorit për çështje programore, Emilija Janevska, të japë arsytim për pikat 3 dhe 4 të rendit të ditës, të cilat kanë të bëjnë me propozimet për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj ShTR Televizioni Makpetrol ShPKNjP Shkup për shkelje të nenit 98, paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe nenit 14, paragrafi (4) të Rregullores për teknikat e reja të reklamimit, si dhe ndaj ShTR Alsat-M ShPK Shkup për shkelje të nenit 54, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Udhëheqësja e Spektorit për çështje programore, Emilija Janevska, shpjegoi se shkeljet tek të dy transmetuesit u konstatuan gjatë mbikëqyrjes së rregullt programore të kryer në maj 2026. Në lidhje me TV Makpetrol, ajo vuri në dukje se është konstatuar shkelje e nenit 98, paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe nenit 14, paragrafi (4) të Rregullores për teknikat e reja të reklamimit, sipas të cilave midis dy reklamave në ekran të ndarë duhet të kalojë një periudhë prej së paku 15 minutash, me qëllim mbrojtjen e integritetit të veprës audiovizuele dhe bartjen e të drejtës autoriale. Gjatë mbikëqyrjes, u konstatua se në emisionin dokumentar-argëtues "Aventurat e Markut"(Aventurite na Mark) dhe në emisionin argëtues "Ruga ime drejt suksesit"(Mojot pat do uspehot), transmetuar më 4 maj 2026, nuk është respektuar intervali kohor i përcaktuar me ligj midis ndërhyrjes me reklama. Janevska shtoi se TV Makpetrol ka shfrytëzuar të drejtën e saj ligjore për deklarim dhe njoftoi Agjencinë se tashmë kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme për mënjanimin e parregullsive të konstatuara.

Në lidhje me TV Alsat-M, Janevska sqaroi se është konstatuar shkelja e nenit 54, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, i cili i modifikon rregullat

për programet e sponsorizuara. Gjatë mbikëqyrjes, u konstatua se në emisionin reprizë të sponsorizuar argëtues-dokumentar "1001 Vakte"(1001 obrok), transmetuar më 4 maj 2026, u promovua dhe u nxit blerja e dy produkteve të markave "Raid" dhe "Autan" të kompanisë "SC Johnson", e cila është shënuar si sponsor i emisionit. Produktet u promovuan dhe nga moderatorja, si edhe përmes mjeteve vizuale gjatë dhe në fund të emisionit, gjë që është në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-2416/1 të datës 9.6.2026 dhe njëzëri konkludoi ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Televizioni Makpetrol ShPKNjP Shkup, t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 98, paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe nenit 14, paragrafi (4) të Rregullores për teknikat e reja të reklamimit dhe në përputhje me pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (tekst i pastruar) nr.01-4241/1 të datës 1.10.2025, ku urdhërohet në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit për paralajmërim publik të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Rregulloren për teknikat e reja të reklamimit.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj subjektit në fjalë të mbikëqyrjes.

Spektori për çështje programore të kryejë mbikëqyrje kontrolli me qëllim përcaktimin nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar paralajmërim publik (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar), pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin individual (aktvendimin) e miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore nr.10-2421/1 të datës 9.6.2026 dhe njëzëri konkludoi ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Alsat-M ShPK Shkup, t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 54, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (tekst i pastruar) nr.01-4241/1 të datës 1.10.2025, dhe urdhëroi në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit për shqiptimin e masës paralajmërim publik të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj subjektit në fjalë të mbikëqyrjes.

Spektori për çështje programor të kryejë mbikëqyrje kontrolli me qëllim përcaktimin nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar paralajmërim publik (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar), pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin individual (vendimin) e miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 5

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që Drejtori i Agjencisë të miratojë Vendim për pagesën e ndihmës financiare - donacion në shumë prej 120.000,00 (njëqind e njëzet mijë) denarë. Mjetet për realizimin e ndihmës financiare - donacionit janë siguruar në Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani